



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

633-22-6992-2-2-1/C580

KOMUNA E ISTOGUT, - Njësia e Prokurimit, të cilën e përfaqson z. Gëzim Ademaj, ne cilesinë e Zyrtarit pergjegjes i prokurimit (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;

Dhe

Mirsad Smakij, B.I. me NRB 810297285 cilën e përfaqëson z. Mirsad Smakij (**më tej i quajtur "Kyersi i shërbimeve"**), në anën tjetër, janë pajtuar si në vijim:

LOT 13 – TRANSPORTI I NXËNËSVE NGA FSHATRA E NDRYSHME DERI NE – SHF "FAN NOLI" DOBRUSHË me numër identifikues: 633-22-6992-580

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim: **"TRANSPORTI I NXËNESVE NE RELACIONIN SI MË LARTË" LOT 13**

<i>Nr. I prokurimit</i>	633-22-6992-2-2-1/C580
"I brendshëm"	633-22-036-2-2-1/C580

[Autoriteti kontraktues kryen blerje vetëm në emër të vet]

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuar, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit të sajë dhe përfundon në datën: **01.09.2024**

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë **10** ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues, ndërsa afati i skadimit të kontratës është: **24 muaj** pas datës së nënshkrimit të sajë, perkatësisht deri me **01.09.2024**

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë: Relacioni Fshatra te ndryshme – **“FAN NOLI” DOBRUSHË**

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve Ofertën Financiare e kontraktorit e datës: **03.08.2022** dhe atë: **LOT 13 – TRANSPORTI I NXËNËSVE NGA FSHATRAT E NDRYSHME DERI NE – SHF “FAN NOLI” DOBRUSHË** është **30,00 €** per një ditë-transport ditor

Vlera totale indikative e kontratës për tri Lotet është **9.000,00 € Nëntë mijë Euro**.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njërive do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;
- (g) *Plani për mëxim të kontratës*

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e


Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Gëzim Ademaj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	Mirsad Smakiq
Pozita:	Drejtör
Nënshkrimi:	
Data:	08-09-2022
Vula:	

STR-DPT
"MELIS"
Dobrusa - Istok

KUSHTET E VEÇANTA

633/022/6992/221c580

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe
Siguria e ekzekutimit	8.1	Sigurimi i ekzekutimit të kontratës do të bëhet nga kontraktori në një afat prej 25 mujsh, nga data e nënshkrimit të kontratës në vlerë 10% e kontratës.
Sigurimi	9.1	<i>Pjese e dosjes se tenderit</i>
Vonesat e ekzekutimit	14.1	<i>Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë.</i>
Cilësia e furnizimeve	16.2	<i>Artikujt duhet të jenë të kualitetit me specifikat e parapara, bazuar në pershkrimin teknik të ofertës.</i>
Inspektimi dhe testimi	17.2	<i>Menaxheri i kontratës do të jetë caktuar Shiqere Gashi, Drejtoreshë "Fan Noli" Dobrushë me vendim nga ZKA-ja Nr. 01-662/2022 datë 05.09.2022 icili do të bëjë implementimin e kontratës dhe planin për menaxhimin e kontratës.</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	29.2	<i>Komisioni Komunal, me së paku tri takime</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	30.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Ekonomike-Departamenti për çështje ekonomike-Prishtinë

Loto 12	NGA FSHATRATE NDRYSHME NE SH.F.FAN NOLI-DOBRUSHË			
	Transporti i nxënësve në relacionin: fshati Veriç-- sh.f. "Fan Noli" ne Dobrushë dhe anasjelltas.(16 km dy drejtimet, 15 nxënës)	dite	368	/
Loto 13	NGA FSHATRATE NDRYSHME NE SH.FAN NOLI-DOBRUSHË			
	Transporti i nxënësve në relacionin: fshati Lubovë-- sh.f. "Fan Noli" ne Dobrushë dhe anasjelltas.(12 km dy drejtimet, 7 nxënës)	dite	368	30
Loto 14	Transporti Për nevoja të institucioneve komunale dhe anasjelltasd(nxenes ne gara te ndryshme,mesimdhene ne trajnime,si dhe per nevoja të ndryshme).Fillimi i regjistrimit të kilometrave bëhet nga vendnisja e caktuar nga Drejtorati i Arsimit apo Drejtoratet tjera varsisht se kush ka nevoje për këtë shërbim)	km	5000	/

Oraret e mësim:

Ndrrimi I paradites:ora 8.00-13.05

Ndrrimi I pasdites:ora 13.00-17.25

Operatori ekonomik fitues duhet kordinoj kohën , në mënyrë që nxënësit të mos vonohen në mësim.

Për ndrrimin e paradites nxenesit ne shkolle duhet të jenë jo më heret se 7.40 minuta dhe jo me vonë se 7.50 minuta,çdo sjellje e nxenesve më heret apo më vonë do të sanksionohet kompanija.


 STR-DPT
"MELIS"
 Dobruša - Istok

810 291 285 | 180

Mirsad Svec